



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:228074

Datë: 26.02.2024

Numri i dokumentit: 05371155

C.nr.3473/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Njomëza Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale D.A. në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditëses A.A. me numër personal të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare “Klinaku” me avokatët e saj S.K. etj nga Prishtina, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. - Spitali Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13-të, jashtë seancës gjyqësore, më datë 26.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi e pa bazuar** kërkesëpadia e paditëses A.A. nga Prizreni, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. - Spitali Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, me të cilën ka kërkuar që të: *“DETYROHET e paditura që paditëses në emër të kompensimit të pagave të 13-të për vitet 2020, 2021, 2022 t’ia paguajë shumën prej 1,131.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% e cila llogaritet nga data e parashtrimt të padisë e deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimt e përmbarimit të dhunshëm”*.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja A.A. nga Prizreni, përmes Shoqërisë së Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare “Klinaku” me avokatët e saj S.K. etj nga Prishtina, pranë kësaj gjykate, me datë 26.10.2023 ka paraqitur padi kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, me objekt të padisë kompensimi i pagave të 13-ta.

Të autorizuarit e paditëses në padi kanë theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune të rregullt tek e paditura për më tepër se 27 vite. Marrë për bazë dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 12.06.2018 e lidhur në mes palëve Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, Ligjit të Punës dhe Kontratës Individuale e paditura nuk e ka bërë kompensimin e pagave të 13-ta për vitet 2020, 2021 dhe 2022 ashtu siç i takon sipas përvojës së punës. Lartësia e llogaritjes së 3 (tri) pagave të

13-ta mbështetet në realizimin e pagës në muajin e fundit të paditëses dhe sipas listës së pagës, paga bazë e paditëses është 377.00 €. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e vet, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura me datë 09.01.2024 ka paraqitur përgjigje në padi, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Ka theksuar se e paditura, paditëses ia ka refuzuar kërkesën për kompensimin e pagave të 13-ta. Paditësi kërkesën e bazon në nenin 17 par. 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale, mirëpo një kërkesë e tillë është e pabazuar, pasi që nuk kanë mundësi buxhetore për një gjë të tillë, për shkak mjeteve të kufizuara buxhetore. Në këtë drejtim, me njoftimin nr. prot. 3823 të datës 21.12.2023, ka njoftuar gjykatën se që nga viti 2018 e deri në vitin 2022, nuk kanë pasur mundësi buxhetore që të përmbushin pagën e 13-të për të punësuarit e saj, sepse kanë qenë deficit. Andaj, ka propozuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e refuzoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në Sh.S.K.U.K. - Spitalin Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren dhe e njëjta ka pagë bazë prej 377.00 euro.

Kontestuese në mes palëve ishte nëse paditëses i takon e drejta për kompensimin e pagës së trembëdhjetë (13).

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, të lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018 deri më datë 10.06.2021. Me nenin 17 par. 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, është paraparë se *"punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit"*.

Pastaj, bazuar në Mendimin Juridik nr. 212/2023 të datës 09.10.2023, përcaktohet në mënyrë shprehimore se çështja e kompensimit të pagës së trembëdhjetë (13), për punëtorët shëndetësor është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, respektivisht nëse punëdhënësi ka mjete buxhetore. Pra, e drejta e punëmarrësit (paditëses) për të realizuar pagën e trembëdhjetë (13), krijohet kur punëdhënësi (e paditura) nuk e përmbushë atë, ndërsa nuk arrin të provojë se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Në fund, është në barrën e punëdhënësit që të provojë çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e një kërkesë të tillë.

Së këndejmi, me njoftimin nr. prot. 3823 të datës 21.12.2023, e paditura në mënyrë konkrete dhe të detajuar ka ilustruar të dhënat se që nga viti 2018 e deri në vitin 2022, nuk ka pasur mundësi buxhetore për të realizuar pagën e trembëdhjetë (13) për punëtorët (paditësin).

Andaj, gjykata vlerëson se dispozita ligjore e nenit 17 par. 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, nuk është e karakterit detyrues për palët kontraktuese. Kështu, duke u mbështetur edhe në Mendimin juridik nr. 212/2023 të datës 09.10.2023, duke qenë se të provuarit e faktit nëse ka mundësi buxhetore i ka takuar të paditurës, e njëjta me njoftimin nr. prot. 3823 të datës 21.12.2023, ka provuar se nuk ka mundësi buxhetore për të kompensuar pagën e trembëdhjetë (13) ndaj paditësve. Kësisoj, gjykata duke vlerësuar bazën ligjore të theksuar më lartë dhe gjendjen faktike të vërtetuar, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve duhet refuzuar si e pabazuar. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia e paditësve, qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe në bazën juridike konkrete.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 par. 1 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*. Ndërsa në paragrafin 2 të nenit të lartcekur është paraparë se *“kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së, ku është obliguar që secila palë ti bartë shpenzimet e veta, pasi që e paditura nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.3473/23 të datës 26.02.2024

B. Profesionale
Delvina Ajazaj

Gjyqtarja
Njomëza Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.